

16 Rritet mundësia e kreditimit për bizneset në Kosovë

14 Dekada e dyfishimit të depozitave

IBANK

Tetor 2018 | Nr. 15 - Gratis

Rekordi i depozitave, mbi 3.1 miliardë euro

FAQE 03

TË GJITHA DEPOZITAT JANË TË SIGURTA

Violeta Arifi-Krasniqi, drejtoreshë menaxhuese e Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë, thotë se depozitat në sektorin bankar të vendit kanë kaluar shifrën prej 3 miliardë euro. Sipas saj, mjetet e qytetarëve në banka janë të sigurt

FAQE 10

Analizë mbi ecurinë e depozitave

FAQE 02



Analizë mbi ecurinë e depozitave

Financimi i aktivitetit të bankave që operojnë në Republikën e Kosovës, sigurohet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda vendit, të cilat mund të konsiderohen si burime më stabile të financimit. Depozitat në sektorin bankar edhe gjatë këtij viti po karakterizuan me rritje të qëndrueshme, duke vazhduar kështu trendin rritës qysh prej vitit 2002. Besimi i lartë i publikut në sektorin bankar të Kosovës, i bazuar në fundamentet e shëndosha mbi të cilat është ndër-tuar dhe zhvilluar ky sektor, ka bërë që depozitat në këtë sektor të jenë të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës së funksionimit të tij, përfshirë edhe periudhën e krizës globale.

Rritja e vazhdueshme e depozitave në sektorin bankar të Kosovës, përveç që ka qenë proces i natyrshëm i zhvillimit të një sektori të ri bankar, është ndikuar gjithashtu nga faktorë tjerë me ndikim të rëndësishëm në ekonomi.

Normat e interesit në depozita për vite me radhë, përjashtuar vitet e fundit, kanë qenë mjaft të larta dhe si të tilla i kanë bërë depozitat në sektorin bankar një instrument mjaft tërheqës për të investuar. Pastaj, rritja e vazhdueshme ekonomike ka bërë që të rriten të ardhurat e qytetarëve dhe bizneseve, duke ndikuar kështu pozitivisht në kapacitetin e ekonomisë për të gjeneruar kursime. Ndikim të rëndësishëm pa dyshim se ka pasur edhe rrjedha e qëndrueshme e transfereve nga jashtë, kryesisht remitencave, një pjesë e të cilave ka përfunduar si depozita në sektorin bankar.

Deri në korrik të vitit 2018, gjithsej depozitat shënuan rritje vjetore prej 5.6 përqind dhe arritën vlerën prej 3.13 miliardë euro. Rritja e qëndrueshme e depozitave ka qenë njëri ndër faktorët kryesor mbështetës për rritjen e kreditimit nga sektori bankar. Rrjedha e



Burimi kryesor i depozitave në sektorin bankar të Kosovës janë depozitat e ekonomive familjare, të cilat përfaqësojnë rreth 72 përqind të gjithsej depozitave. Vlera e këtyre depozitave në korrik 2018 ishte 2.25 miliardë euro, e cila është për 5.2 përqind më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

qëndrueshme e depozitave drejt sektorit bankar ka bërë që ky sektor të jetë në gjendje që në vazhdimësi të rrisë financimin për ekonominë e vendit dhe në të njëjtën kohë të ruaj pozicionin e kënaqshëm të likuiditetit. Formimi dhe menaxhimi i një baze të qëndrueshme të depozitave nga sektorët e brendshëm ka ndihmuar bankat që operojnë në Kosovë të mirëmbajnë një shkallë relativisht të ulët të mbështetjes në burime të jashtme të financimit, gjë e cila ka kontribuar në zvogëlimin e ndjeshmërisë së aktivitetit bankar në Kosovë ndaj zhvillimeve në tregjet e jashtme.

Burimi kryesor i depozitave në sektorin bankar të Kosovës janë depozitat e ekonomive familjare, të cilat përfaqësojnë rreth 72 përqind të gjithsej depozitave. Vlera e këtyre depozitave në korrik 2018 ishte 2.25 miliardë euro, e cila është për 5.2 përqind më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Depozitat e ekonomive familjare, duke qenë se janë të shpërndara

në një numër më të madh të depozitorëve, konsiderohen të jenë më stabile dhe zvogëlojnë ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të tërheqjes së menjëhershme të tyre, duke i kontribuar kështu zvogëlimit të rrezikut të likuiditetit për bankat.


Kategoria e dytë e depozitave për nga pjesëmarrja në gjithsej depozitat janë depozitat e ndërmarrjeve, të cilat përfaqësojnë rreth 24 përqind të gjithsej depozitave. Në krahasim me depozitat e ekonomive familjare, depozitat e ndërmarrjeve në periudhën e fundit janë karakterizuar me normë të rritjes dukshëm më të ulët. Vlera e tyre në korrik 2018 ishte 700.4 milionë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 1.5 përqind.

Ambienti i normave të ulëta të interesit në depozita qysh nga vitit 2014, dhe i cili po mbizotëron ende, është reflektuar në strukturën e përgjithshme të depozitave, ku vërehet një zhvendosje nga depozitat e afatizuar drejt depozitave të transferueshme. Kjo për faktin se normat e ulëta të interesit kanë dekurajuar afatizimin e mjeteve. Si rrjedhojë, pjesëmarrja e depozitave të transferueshme në gjithsej depozitat në korrik 2018 ishte 60 përqind, krahasuar me pjesëmarrjen prej rreth 42 përqind në vitin 2014.

Përqendrimi i lartë i depozitave në depozita të transferueshme vështirëson rritjen e kredive me afat më të gjatë maturimi, prandaj mund të pritët që të ketë rritje të konkurrencës ndërmjet bankave për të tërhequr depozita me afat më të gjatë maturimi, e cila mund të manifestohet me norma më të lartë të interesit në depozita.

Në vitin 2018 vërehet një tendencë e rritjes së normave të interesit në depozita, të cilat në korrik 2018 kishin një mesatare prej 1.54 përqind, krahasuar me 1.17 përqind në korrik 2017.

**(KJO ANALIZË ËSHTË PËRGATITUR
NGA BANKA QENDRORE E KOSOVËS)**



Rekordi i depozitave, mbi 3.1 miliardë euro

Depozitat e përgjithshme në sektorin bankar të Kosovës kanë arritur në 3.13 miliardë euro. Gjatë dekadës së fundit depozitat kanë shënuar rritje mesatare vjetore prej më shumë se 10 për qind

Mbi 3.1 miliardë euro ka arritur shuma e përgjithshme e depozitave në sektorin bankar të Kosovës, shifër kjo rekorde e parave të deponuara në banka që nga paslufta e këndeje. Zyrtarë të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) bëjnë të ditur se është interesant fakti se depozitat e qytetarëve në bankat vendore kanë shënuar rritje edhe përgjatë periudhës së krizës financiare globale që kishte nisur në vitin 2008, përderisa rritja mesatare vjetore e depozitave gjatë dekadës së fundit ka qenë 10.2 për qind.

Derisa është konfirmuar në vazhdimësi qëndrueshmëria e bankave në Kosovë

dhe besimi i qytetarëve ndaj tyre edhe norma e interesit në depozita në vend është ndër më të lartat në rajon, përkatësisht më e lartë se në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi.

DEPOZITAT NË KOSOVË U RRIJEN EDHE PËRGJATË PERIUdhËS SË KRIZËS GLOBALE

Fehmi Mehmeti, guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës, bënë të ditur se në fund të korrikut të këtij viti shuma e përgjithshme e depozitave në sektorin bankar të vendit ka arritur në 3.13 miliardë euro dhe nëse krahasohet me periudhën e njëjtë të vitit paraprak depozitat janë

rritur për 5.6 %.

Sipas tij, dy kategoritë kryesore të depozitave në bankat në Kosovë, e që janë depozitat në llogaritë rrjedhëse, si dhe depozitat e afatizuara kanë shënuar po ashtu rritje vjetore prej 7.9% respektivisht 7.3%. Rritja e depozitave në sektorin bankar të Kosovës ka qenë mjaft e qëndrueshme përgjatë gjithë periudhës së funksionimit të këtij sektori dhe rrjedhimisht ka mundur edhe një rritje të qëndrueshme të kreditimit bankar.

3.13 MILIARDË €

KA ARRITUR SHUMA E PËRGJITHSHME
E DEPOZITAVE NË SEKTORIN BANKAR TË KOSOVËS



2.2 MILIARDË €

JANË DEPOZITA TË EKONOMIVE FAMILJARE NË BANKA.



507.5 MILIONË €

JANË DEPOZITA TË BIZNESEVE NË SEKTORIN BANKAR.



10.2%

ËSHTË NORMA MESATARE
VJETORE E RRIJES SË
DEPOZITAVE PËRGJATË
DEKADËS SË FUNDIT.



3.8%

ËSHTË PJESËMARRJA E DEPOZITAVE
TË JOREZIDENTËVE NË SHUMËN E
PËRGJITHSHME TË DEPOZITAVE NË
SEKTORIN BANKAR.



VIJON NGA FAQE 03

‘Depozitat në sektorin bankar të Kosovës gjatë dhjetë viteve të fundit janë karakterizuar me një rritje mjaft të qëndrueshme, e cila reflekton aftësinë e ekonomisë së vendit për të gjeneruar kursime, por edhe besimin e qëndrueshëm të publikut në sektorin bankar’, ka thënë Mehmeti, duke shtuar se vlen të theksohet se depozitat në sektorin bankar të Kosovës vazhduan të rriten edhe përgjatë periudhës së krizës globale, me ç’rast u konfirmua qëndrueshmëria e bankave në vend dhe besimi i publikut ndaj tyre.

Norma mesatare e rritjes së depozitave në sektorin bankar të Kosovës përgjatë dhjetë viteve të fundit është 10.2 për qind.

KOSOVA ME KAMATA MË TË LARTA NË DEPOZITA

Në rritjen e qëndrueshme të depozitave në banka kanë ndikuar edhe normat më të favorshme të interesit, në krahasim me shumicën e vendeve të rajonit.

Në Kosovë norma mesatare e interesit në depozita në fund të korrikut të këtij viti ishte 1.54%, që paraqet nivelin më të lartë përgjatë vitit 2018, dhe ka shënuar rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kur norma e interesit në depozita ishte 1.17%.

Bazuar në të dhënat e publikuara nga vendet e rajonit, normat e interesit në depozita në Kosovë janë më të larta se ato në Shqipëri prej 1.2%, Maqedoni 1.47% dhe në Malin e Zi 0.61%.

DEPOZITAT E EKONOMIVE FAMILJARE 72%, TË BIZNESEVE 16.2%

Nga gjithsej 3.13 miliardë euro depozita, sa

ishin në korrik 2018, pjesëmarrja e depozitave të ekonomive familjare ishte rreth 2.2 miliardë, apo rreth 72%, ndërsa për bizneset (korporata jofinanciare) vlera e depozitave është rreth 507.5 milionë, apo rreth 16.2% e gjithsej depozitave. Pjesa tjetër e depozitave është e sektorëve tjerë të ekonomisë.

Zyrtarët e BQK-së thonë se depozitat e ekonomive familjare në vazhdimësi kanë përfaqësuar burimin kryesor të financimit të bankave në Kosovë dhe janë përdorur kryesisht për të financuar bizneset përmes kredive të lëshuara.

MILIONAT NGA DIASPORA NË BANKAT KOSOVARE

Në anën tjetër, depozitat e jorezidentëve janë 118.4 milionë euro, krahasuar me nivelin prej 105.6 milionë euro sa ishin në korrik 2017. Pjesëmarrja e depozitave të jorezidentëve në gjithsej depozitat e sektorit bankar, në muajin korrik 2018 ishte 3.8%, përqindje kjo e përafërt me mesataren e periudhës 2015 – korrik 2018.

Guvernatori Mehmeti pranon se rritja më e theksuar e depozitave të jorezidentëve në bankat në Kosovë është ajo e viteve 2008-2009 si dhe 2014-2015, periudha këto që korresponduan me krizën financiare globale dhe me aplikimin e normave negative të interesit në

banka të Bashkimit Evropian.

‘Bazuar në statistikat e publikuara, sikurse është cekur më sipër, ka rritje të vazhdueshme të depozitave në sektorin bankar në Kosovë e ku vlera e tërësishme e depozitave të jorezidentëve, që në masë të konsiderueshme përbëhet nga diaspora kosovare është 118.4 milion euro’, thotë Mehmeti.

NË KOSOVË NORMA MESATARE E INTERESIT NË DEPOZITA NË FUND TË KORRIKUT TË KËTJ VITI ISHTE 1.54%, QË PARAQET NIVELIN MË TË LARTË PËRGJATË VITIT 2018, DHE KA SHËNUAR RITJE KRAHASUAR ME PERIUDHËN E NJËJTË TË VITIT TË KALUAR, KUR NORMA E INTERESIT NË DEPOZITA ISHTE 1.17%.

MBI 2.1 MILIONË LLOGARIBANKARE

Në tremujorin e parë të vitit 2018, numri i përgjithshëm i llogarive bankare ishte rreth 2.1 milionë, nga të cilat 98.2% janë llogari të rezidentëve, ndërsa pjesa tjetër janë llogari të jorezidentëve.

Në krahasim me tremujorin e kaluar, numri i llogarive ka shënuar rritje rreth 7.5%. ‘Nëse krahasimin e bëjmë me

periudhën e njëjtë të një viti më parë, vërejmë se numri i përgjithshëm i llogarive është rritur për rreth 11.9%. Nga numri i përgjithshëm i llogarive të klientëve, 80.9% e tyre janë llogari rrjedhëse, 17.8% llogari të kursimeve dhe 1.3% llogari të depozitave të afatizuara’, bënë të ditur guvernatori i BQK-së.



VIJON NGA FAQE 06

SIGURIMI I DEPOZITAVE

Depozitat në sektorin bankar janë të sigurta dhe mbikëqyren shumë për së afërmi konform qasjes së bazuar në rrezik dhe krahas parimeve dhe praktikave më të mira bashkëkohore ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes bankare. Pragu i shumës së depozitave të siguruar nga Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK) është rritur në 5,000 euro.

‘Shuma e siguruar nga FSDK mbulon 98.6% të depozitorëve. Në raport me gjithsej shumën e depozitave në sektorin bankar, shumta e siguruar është ekuivalente me 23.9%’.

Violeta Arifi-Krasniqi, drejtoreshë menaxhuese e Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë, thotë se Kosova në raport me vendet e rajonit ka limitin më të ulët të sigurimit të depozitave. Mirëpo, sipas saj, vlerësimi nëse limiti i sigurimit të depozitave është adekuat varet nga përqindja e depozitoreve plotësisht të mbuluar që në Kosovë është 90.09%, që do të thotë që rreth 90% e depozitorëve të siguruar kanë depozita deri në limitin e sigurimit.

RRITJA E DEPOZITAVE MUNDËSOI ZGJERIMIN E KREDITIMIT

Kryetari i Bordit të BQK-së, Flamur Mrasori, thotë se rritja e qëndrueshme e depozitave ka mundësuar zgjerimin e vazhdueshëm të kreditimit bankar në ekonominë e vendit, duke shërbyer kështu si burim shumë i rëndësishëm për financimin e bizneseve. ‘Aktualisht, sektori bankar i Kosovës ka potencial të mjaftueshëm për të zgjeruar edhe më tutje kreditimin, mirëpo për të pasur një rritje edhe më të madhe të kreditimit ndikim të rëndësishëm ka edhe madhësia dhe cilësia e kërkesës për kredi.

“Sa iu perket depozitave të ekonomive familjare, ato janë rritur ngase qytetarët nuk mund t’i ruajnë parat në shtëpi, sepse kanë frikë nga vjedhjet e shpeshta që ndodhin në vend, deri sa rritja e depozitave të bizneseve mendoj se ato janë rritur, pasi që për shkak të stabilitetit të brishtë politik bizneset nuk kanë kryer planin e investimit të cilin ata e kanë paraparë me plan biznesi”, ka thënë dekani Shabani.

Prandaj, përmirësimi i kushteve të kreditimit që ka ndodhur viteve të fundit, së bashku me mbështetjen e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, si dhe një rikuperim më i madh i sektorëve me qasje më të ulët në kredi bankare, sigurisht se do të rezultojë në një kreditim më të madh për këta sektorë në periudhat e ardhshme’, shprehet Mrasori.

SHATRI: BANKAT SHUMË TË SIGURTA

Haki Shatri, ish- ministër i Ekonomisë dhe Financave dhe aktualisht këshilltar për ekonomi i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se rritja e vazhdueshme e depozitave në bankat komerciale është një sinjal i mirë që bankat në Kosovë janë shumë të sigurta.

“Është shumë e mirë për shtetin, por edhe për investitorët e huaj siguria e madhe në sistemin bankar të vendit. Të gjitha bankat që operojnë në Kosovë performojnë mirë dhe deri më tash nuk kanë pasur ndonjë problem. Ky është sinjal i mirë”, ka thënë Shatri.

Shatri thotë se normat e interesit në depozita nuk mund të rriten edhe më tutje, pasi që sipas tij, bankat kanë në dispozicion një shumë të madhe të parave, të cilat, sipas tij, janë të pa afatizuara.

“Për depozita të afatizuara mbi 2 vite qytetarët mund të përfitojnë nga norma e interesit, e cila është rreth 2 për qind, por për momentin për depozita të pa afatizuara qytetarët nuk mund të përfitojnë asgjë. Fatkeqësisht shumica e depozitave janë të tilla. Qytetarët i mbajnë parat në banka, jo për qëllim të përfitimit, por vetëm për shkak të sigurisë”, ka thënë Shatri.

ARSYET E RITJES SË DEPOZITAVE

Halit Shabani, dekan i Fakultetit të Biznesit “Haxhi Zeka” në Pejë, thotë se nëse bëjmë një krahasim të normës së interesit për depozita të afatizuara që aplikohen tash, me ato që janë aplikuar vitin e kaluar ka një ngritje. Por, sipas tij, ato duhet të ngrihen edhe më shumë, pasi që, siç thotë ai, dallimi mes normës së interesit në kredi dhe asaj në depozita është ende i madh. Profesor Shabani thotë se janë dy arsye pse në vendin tonë ka rritje të shumës së depozitave nëpër bankat komerciale.

“Sa iu perket depozitave të ekonomive familjare, ato janë rritur ngase qytetarët nuk mund t’i ruajnë parat në shtëpi, sepse kanë frikë nga vjedhjet e shpeshta që ndodhin në vend, deri sa rritja e depozitave të bizneseve mendoj se ato janë rritur, pasi që për shkak të stabilitetit të brishtë politik bizneset nuk kanë kryer planin e investimit të cilin ata e kanë paraparë me plan biznesi”, ka thënë dekani Shabani.

11.9%

është rritur për një vit numri i llogarive bankare në Kosovë.

1.3%

janë llogari të depozitave të afatizuara.

80.9%

e llogarive bankare në Kosovë janë rrjedhëse.

17.8%

e llogarive janë të kursimeve



2.100.000

llogari bankare janë në Kosovë.



98.2%

e llogarive bankare janë të rezidentëve.

Baliya: Siguria kibernetike e rëndësishme për zhvillimet e reja në shërbimet digjitale bankare

Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me 'House of Training' nga Luksemburgu kanë organizuar sesionin informues gjysmë-ditor me temën "Menaxhimi i Sigurisë Kibernetike dhe Informacionit". Ky sesion informues mbledhi të gjithë akterët relevant nga sektori financiar, si dhe nga organet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e ligjit. Në fjalimin e tij hyrës, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Baliya, theksoi rëndësinë e Sigurisë Kibernetike dhe të Informacionit në kuadër të zhvillimeve të reja në shërbimet digjitale bankare.

Tutje, ai përmendi një ndër faktorët më me rëndësi në avansimin e shërbimeve bankare dhe raporteve bankë-klient siç është besimi në sigurinë e shërbimeve bankare në veçanti atyre elektronike. Gjithsesi, industria bankare në Kosovë është duke bërë investime të vazhdueshme në siguri, por edhe në ngritjen e kapaciteteve njerëzore në lidhje me sigurinë kibernetike dhe të informacionit dhe kjo është e evidente edhe nga trajnimet dhe sesionet e organizuara nga Shoqata e Bankave të Kosovës në partneritet me institucionet ndërkombëtare me përvojë të gjerë në këtë fushë siç është: House of Training nga Luksemburgu. 'Qëllimi ynë si sektor bankar është që të iu ofrojmë klientëve bankar një shërbim sa më të lehtë dhe të sigurt në mënyrë që ata t'i realizojnë qëllimet e tyre me ndihmën e bankës, por për të arritur më shumë progres në këtë drejtim na duhet të koordinojmë dhe bashkëveprojmë me institucionet relevante siç është Policia e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës dhe institucionet tjera relevante'.

Ligjeruesi prezantoi materiale inform-



uese për të pranishmit nga perspektiva globale e kësaj çështje, e cila është duke marrë vëmendje të madhe nga sistemet financiare edhe në vendet e zhvilluar, por në veçanti në ato në zhvillim si Kosova. Në pjesën e diskutimit pjesëmarrësit parashtruan pyetje konkrete tek ligjeruesi Hristiyan Lazarov, si dhe zhvilluan një

diskutim të gjerë rreth kësaj fushe. Përveç mundësisë për diskutim rreth kësaj teme mjaft të rëndësishme në bankimin e ditëve të sotme, gjithashtu pjesëmarrësit patën mundësinë për rrjetëzim dhe shkëmbim të ideve rreth temës. Një përkrahje e rëndësishme për këtë event u ofrua edhe nga kompania Asseco.

Rritet mundësia e kreditimit për bizneset në Kosovë

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) ka njoftuar se bankat e Kosovës kanë rritur kreditimin për biznese këtë vit, duke arritur në një rritje prej 11.3% e që është rritja më e madhe në tri vitet e fundit. Sipas drejtorit ekzekutiv të Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Baliya, kjo rritje paraqet edhe rritje të qasjes në financa për bizneset, kështu duke mbështetur zgjerimin e bizneseve dhe rritjen e punësimit në Kosovë nga sektori real. Ai potencoi punën e rëndësishme që janë duke

bërë institucionet financiare, përkatësisht bankat e Kosovës, për të financuar zhvillimin ekonomik të vendit, i cili është ngushtë i ndërlidhur me perspektivën e Kosovës dhe zhvillimin e mëtutjeshëm social dhe ekonomik.

Në të njëjtën kohë, Baliya potencoi rëndësinë e zgjidhjes së çështjes së titujve pronësorë për t'i mundësuar ekonomive familjare në Kosovë që të financojnë më lehtë dhe më lirë pronën e tyre të banimit, pasi që kjo është

një parakusht i rëndësishëm i mirëqenies socio-ekonomike të secilës familje. Në këtë drejtim kërkohet që secili pushtet komunal të ketë një plan strategjik për të pajisur me tituj pronësor të gjithë ata që janë të interesuar të blejnë pronë banesore, si dhe atyre që tanimë veç se janë pronar me kontratë të shitblerjes, por që u mungon titulli pronësor. Sipas tij, zgjidhja e kësaj çështjeje do të ndikonte në shumë hallka të ekonomisë së vendit, të cilat janë të ndërlidhura me pronën.

Të dhëna kumulative për të gjitha institucionet anëtare

K2 2018

○ Gjithsej depozitues (numri)	940,667
○ Depozituesit e siguruar (numri)	927,322 në % të totalit 98.58%
○ Totali I depozitave (në euro)	3,100,310,608
○ Depozitat e siguruara (në euro)	724,207,272 në % të totalit 23.9%

Të dhëna kumulative për të gjitha institucionet anëtare

	Nr. i depozituesve	në %	Kërkesat neto në '000 euro	në %
○ Totali i siguruar <= 5,000 euro, prej të cilave	843,075	100%	302,972,272	100%
○ Totali i personave fizik	792,374	94.0%	282,307,543	93.2%
○ Totali i personave juridik	50,701	6.0%	20,664,730	6.8%
○ Totali i siguruar >5,000 euro, prej të cilave	84,247	100%	2,552,710,875	100%
○ Totali i personave fizik	76,238	90.5%	1,958,630,183	76.7%
○ Totali i personave juridik	8,009	9.5%	594,080,693	23.3%
○ Gjithsej	927,322			

Bankat me rreth 1 milion depozitues

Numri i përgjithshëm i depozituesve në bankat komerciale të Kosovës kalon shifrën prej 940 mijë, të cilët i kanë mbi 3.1 miliardë euro para të gatshme në banka.

Sipas raporteve zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), mbi 840 mijë klientë i kanë deri në 5000 mijë euro depozita në

banka komerciale, ndërsa rreth 84 mijë konsumatorë i kanë më shumë se 5000 euro depozita në bankat komerciale të vendit.

Pasi që shumica e depozituesve kanë deri në 5000 euro para në banka dhe sipas legjislacionit në fuqi limiti i sigurimit të depozitave është 5000 euro, vlerësohet se

mbi 90 për qind e depozitave në banka janë të siguruara.

Nga shumta e përgjithshme e depozitave prej mbi 3.1 miliardë euro,

BQK bënë të ditur se mbi 724 milionë euro, apo 23.9% e depozitave të përgjithshme, janë të siguruara.



TË GJITHA DEPOZITAT JANË TË SIGURTA

Violeta Arifi-Krasniqi, drejtoreshë menaxhuese e Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë, thotë se depozitat në sektorin bankar të vendit kanë kaluar shifrën prej 3 miliardë euro. Sipas saj, mjetet e qytetarëve në banka janë të sigurta

Mbi 3 miliardë euro ka arritur shuma e përgjithshme e depozitave në sistemin bankar të Kosovës, përderisa më shumë se 90 për qind e depozituesve i kanë të mbuluara plotësisht mjetet e tyre.

Kjo për faktin se, sipas legjislacionit në fuqi, limiti i sigurimit të depozitave është 5000 euro, me ç'rast 90.09 për qind e depozitave në sektorin bankar janë deri në këtë shumë (5000 euro), përderisa vetëm 9 për qind e depozituesve kanë më shumë se 5000 euro.

Kështu thotë Violeta Arifi-Krasniqi, drejtoreshë menaxhuese e Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovë (FSDK-së), duke shtuar se mandat kryesor i institucionit që e drejton është sigurimi i depozitave të personave fizik dhe juridik në bankat anëtare dhe kompensimi i depozitorëve të siguruar deri në limitin e sigurimit prej 5,000 eurosh brenda tridhjetë (30) ditëve, në rast të revokimit të licencës nga BQK, sipas kriterëve dhe limiteve të përcaktuara në Ligjin për Sigurimin e Depozitave (LSD).

Znj. Krasniqi depozitat e kosovarëve në bankat komerciale të vendit kanë arritur shumën e përgjithshme prej mbi 3 miliardë euro, mjete këto gati sa dyfishi i buxhetit të përgjithshëm të Kosovës. Sa janë të sigurta depozitat e kosovarëve në bankat komerciale?

Arifi-Krasniqi: Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë (FSDK) është themeluar me Ligjin për Sigurimin e Depozitave "LSD" për ta administruar Sistemin e Sigurimit të Depozitave "SSD" në Kosovë. Sistemet e sigurimit të depozitave janë një nga katër shtyllat e rrjetit të sigurisë financiare si: Rregullativës prudenciale dhe mbikëqyrjes efektive, kreditorit të instancës së fundit dhe mekanizmave efektive të zgjidhjes së bankave.

Sistemi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë është themeluar për të përmbushur dy qëllime të Politikës Publike: Mbrojtjen e depozitorëve të vegjël nga humbja në rast të revokimit të licencës të ndonjë banke dhe mbështetjen e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në arritjen e qëllimit të saj për rritjen e sigurisë, solvencës dhe funksionimit efikas të një sistemi stabil, të bazuar në ekonominë e

tregut. Pra, FSDK nuk ka mandat ligjor për vlerësimin e riskut të depozitave në bankat komerciale, por punon për të siguruar gatishmëri operacionale dhe financiare për të përmbushur objektivat e lartcekura të Politikës Publike.

Mandat kryesor i FSDK-së është sigurimi i depozitave të personave fizik dhe juridik në bankat anëtare dhe kompensimi i depozitorëve të siguruar deri në limitin e sigurimit prej 5,000 eurosh brenda tridhjetë (30) ditëve në rast revokimit të licencës nga BQK, sipas kriterëve dhe limiteve të përcaktuara në LSD. Në shtesë, FSDK ka mandat të caktimit dhe arkëtimit të premive të sigurimit; Investimit të Fondit për sigurim të depozitave "FSD"; bashkëpunimin me Bankën Qendrore të Kosovës për shkëmbim të informacionit; pjesëmarrjen me fonde, në bashkëpunim me BQK në zgjidhje të ndonjë banke anëtare në rast të transferimit të detyrimeve të siguruar; huamarrjen në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve; dhe miratimin e legjislacionit sekondar dhe sanksioneve administrative.



SIGURIMI I DEPOZITAVE DERI NË 5000 EURO

Sipas legjislacionit në fuqi, deri në çfarë vlere financiare garantohen depozitat nga shteti dhe a ka ndonjë iniciativë të re për rritjen e vlerës së garantimit të depozitave?

Arifi-Krasniqi: FSDK siguron çdo person fizik dhe juridik që ka të deponuara para në bankat anëtare deri në limitin e sigurimit prej 5,000 euro. Sigurimi vlen në nivel të depozitorit për çdo bankë anëtare të FSDK-së. Anëtarësia në FSDK është automatike me rastin e licencimit nga BQK dhe e detyrueshme në përputhje me ligjin. Një degë e bankës së huaj e licencuar për të pranuar depozita në Kosovë, është e obliguar që të bëhet anëtare e FSDK-së vetëm nëse vendi amë ofron sigurim të depozitave dhe atë me mbulesë më të ulët sesa e përshkruar në ligj.

Anëtarësia e FSDK-së numëron nëntë banka të licencuara nga BQK për të pranuar depozita në Kosovë.

FSDK në përmbushje të planit strategjik 2018-2022, gjegjësisht qëllimit të tretë "Avancimi i legjislacionit sekondar në kornizë gjithëpërfshirëse i mbështetur me udhëzime dhe procedurë dhe harton rekomandimet për plotësim/ndryshimet të Ligjit për Sigurimin e Depozitave në bazë të përvojës operationale" do të shqyrton të gjitha aspektet për të siguruar efektivitet të Sistemit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë, përfshirë analizën e përshtatshmërisë së limitit të sigurimit në mbështetje të stabilitetit financiar.

Nëse bëjmë krahasime me vendet e rajonit, sa është shuma maksimale e depozitave që garantohen në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe si qëndron Kosova

Bankat anëtare të FSDK-së (me renditje sipas alfabetit më 31 dhjetor 2017)

1	Banka Ekonomi
2	Banka Kombëtare Tregtare
3	Banka për Biznes
4	NLB Prishtina
5	ProCredit Bank Kosovë
6	Raiffeisen Bank Kosovë
7	TEB SH.A.
8	Turkiye IS Bankasi, Dega në Kosovë
9	Ziraat Bankasi, Dega në Kosovë

në raport me këto vende?

Arifi-Krasniqi: Kosova në raport me vendet e rajonit ka limitin më të ulët të sigurimit të depozitave. Mirëpo, vlerësimi nëse limiti i sigurimit të depozitave është adekuat varet nga përqindja e depozitoreve plotësisht të mbuluar që në Kosovë është 90.09%, që do të thotë që rreth 90% e depozitorëve të siguruar kanë depozita deri në limitin e sigurimit (sipas të dhënave më 31 dhjetor 2017). Një mbulueshmëri e tillë është në pajtim me Parimin Themelor të IADI-it, Parimi Themelor numer 8: Mbulueshmëria, i cili thekson se për një Sistem efektiv të sigurimit të depozitave, ai duhet të siguroj një numer të madh të depozitorëve, ndërsa shumë më të vogël të depozitave për të ruajtur disiplinën e tregut.

Aka pasur ndonjë rast gjatë viteve të fundit kur janë rrezikuar depozitat në bankat komerciale të Kosovës?

Arifi-Krasniqi: FSDK nuk ka mandat ligjor për vlerësimin e riskut të depozitave në bankat komerciale, por ka mandat të sigurimit të depozitave dhe kompensimit të tyre deri në limitin e sigurimit prej 5,000 euro, brenda tridhjetë

(30) ditëve në rast revokimit të licencës nga BQK, sipas kriteve dhe limiteve të përcaktuara në ligj.

724.2 MILIONË EURO DEPOZITA TË SIGURUARA

Nga shuma e përgjithshme e depozitave në sistemin bankar, sa për qind e këtyre depozitave janë të garantuara sipas ligjeve në fuqi?


Arifi-Krasniqi: Sigurimi i depozitave në sistemin bankar në Kosovë bëhet në pajtim me Ligjin mbi Sigurimin e Depozitave. Nga shuma e përgjithshme prej 3.03 miliardë euro e depozitave të bankave anëtarëve të FSDK-se, shuma prej 724.2 milionë euro janë të siguruara ose 23.9%.

Sa përqind janë depozitues të vegjël, mjetet e cilëve janë të garantuara me Ligj, sa për qind janë depozitues të mëdhenj dhe çfarë sigurie kanë këta të fundit?

Arifi-Krasniqi: Ngjashëm me trendët e viteve të kaluara, raportojmë rritjen e vazhdueshme të totalit të depozitave dhe atyre të siguruara. Kështu më 30 qershor 2018, totali i depozitave arriti në 3 miliardë euro, ndërsa totali i depozitave të siguruara deri në limitin e sigurimit prej 5,000 euro ishte 724 milionë euro, ose 23.9% të gjithë depozitave në bankat anëtare. Gjithsej numri i depozituesve të siguruar, pra personave fizik dhe juridik është 927,322 apo 98.58% të numrit të përgjithshëm të depozituesve të bankave anëtare. Numri i depozituesve të cilët janë të mbuluar plotësisht deri në limitin e sigurimit të depozitave ishte 90.09%, që do të thotë se 843,075 e depozituesve të siguruar kanë depozita deri në euro 5,000.

724.000.000€

është shuma e përgjithshme e depozitave të siguruara në sektorin bankar të Kosovës.



5000€

është përcaktuar me Ligj limiti i sigurimit të depozitave në Kosovë.

Sigurimi i depozitave në sistemin bankar në Kosovë bëhet në pajtim me Ligjin mbi Sigurimin e Depozitave. Nga shuma e përgjithshme prej 3.03 miliardë euro e depozitave të bankave anëtarëve të FSDK-se, shuma prej 724.2 milionë euro janë të siguruar ose 23.9%.



Përderisa 84,221 depozituesve të siguruar apo 9.01%, kanë depozita më shumë se 5,000 euro.

Në mesin e depozituesve në bankat komerciale të Kosovës a ka edhe depozitues të huaj dhe sa është vlera e përgjithshme e depozitave e këtyre të fundit?

Arifi-Krasniqi: FSDK nuk ka në posedim informacionin e kërkuar, pasi që depozitat, në baza tre-mujore, raportohen në nivel të agreguar për indikatorët në vijim: 1. numri i depozitorëve, 2. Numri i llogarive depozituese, dhe 3. Shuma e depozitave (në valutën euro dhe jo-euro).

A është siguria e depozitave dhe normat e favorshme të interesit në depozita që depozituesit e huaj i kanë sjellë paratë e tyre në Kosovë?

Arifi-Krasniqi: FSDK nuk ka mandat ligjor për vlerësimin e riskut të depozitave në bankat komerciale, por ka mandat të sigurimit të depozitave dhe kompensimit të tyre deri në limitin e sigurimit prej €5,000, brenda tridhjetë (30) ditëve në rast revokimit të licencës nga BQK, sipas kriterëve dhe limiteve të përcaktuara në ligj.

Cilat kanë qenë aktivitetet kryesore të institucionit që e drejtoni gjatë viteve të fundit dhe cilat janë synimet për t'i arritur në një të ardhme të afërt?

Arifi-Krasniqi: Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë është themeluar në vitin 2011 sipas LSD për të administruar sistemin e sigurimit të depozitave në Kosovë, projekt zhvillimor, i inicuar nga BQK me mbështetje të plotë nga Qeveria Gjermane (përmes KfW-së). Fillimisht është

përkrahur hartimi i Ligjit për Sigurimin e Depozitave ndërsa mbështetja për themelimin e SSD u formalizua me nënshkrimin e Marrëveshjes trepalëshe të Financimit dhe Projektit në mes të Qeverisë së Kosovës (përmes MF), Qeverisë Gjermane (përmes KfW-së) dhe FSDK-së (si Agjenci për Ekzekutimin e Projektit) në vitin 2012. Marrëveshja e nënshkruar ka paraparë mbështetjen për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave në Kosovë përmes një kontributi në kapital si donacion për FSD-në në shumë totale prej 15.5 milionë euro, ku 11 milionë euro janë dhënë nga Qeveria e Kosovës (përmes Ministrisë së Financave), ndërsa Qeveria Gjermane (nëpërmjet KfW) ka siguruar 4.5 milionë euro kontribut në kapital, dhe 0.5 milionë euro në shërbime këshillimore. Si rezultat i suksesit të projektit fillestar, është nënshkruar Marrëveshja e dytë e Financimit dhe Projektit, në vitin 2013, me donacion në vlerë prej 2 milionë euro e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës (përmes MF), Qeveria Gjermane (përmes KfW) dhe FSDK, për mbështetjen e rritjes së limitit të sigurimit nëpër faza: 3,000 euro (01.01.2014), 4,000 euro (01.01.2016) dhe 5,000 euro (01.01.2018). Prandaj, një nga aktivitetet kryesore të FSDK-se që nga themelimi ishte implementimi i projekteve dhe i kushteve të disbursimit të donacionit dhe kushteve përmblyëse të projektit. Aktivitetet tjera kryesore të viteve të fundit ishin: Nënshkrimi i dy marrëveshjeve për kredi me BERZH për linjat kreditore në "pritje" në shumat 10 milionë euro dhe deri në 24 milionë euro për të siguruar gatishmëri financiare – me garancion nga Ministria e Financave (në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës), nënshkrimi i marrëveshjes së grantit me BERZH-in për zh-

villimin dhe zbatimin e Sistemit për kompensimin e depozituesve në vlerë prej 255,523.34 euro për të siguruar gatishmëri operacionale, nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit me BQK-në për shkëmbim të informacionit dhe investime, plotësimi i rekomandimeve të FSAP-it. Nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit me Fondin e Kursimeve për Sigurimin e Depozitave të Turqisë (SDIF), Agjencinë për Sigurimin e Depozitave të Shqipërisë, Korporatën Federale për Sigurimin e Depozitave (FDIC), Agjencinë Esisuisse të Zvicrës, përmbushjen e një vargu të aktiviteteve për vetëdijësimin e publikut për përfitimet dhe kufizimet e sistemit të sigurimit të depozitave, u ndërmor vlerësimi i SSD-së së Kosovës me Parime Themelore të IADI-it për sisteme efektive të sigurimit të depozitave, etj. Ndërsa për zhvillim institucional, FSDK e ka hartuar planin strategjik pesëvjeçar për periudhën 2018-2022, me temë "Të gatshëm për 7 ditë kompensim në shërbim të depozitorëve dhe stabilitetit financiar" i qasshëm në <http://www.fsdk.org/fsdk-2/plani-strategjik>, ku ka definuar katër qëllime strategjike, si në vijim: Arritja e gatishmërisë operacionale dhe financiare për kompënzim brenda 7 ditëve, arritje e vetëdijësimit të lartë të publikut për sigurim të depozitave dhe përmbushje të standardeve nga Direktiva Evropiane për Garantimin e Depozitave dhe Parimet Themelore të IADI-it, avancimi i legjislacionit sekondar në kornizë gjithëpërfshirëse i mbështetur me udhëzime dhe procedurë dhe harton rekomandimet për plotësim/ndryshime të Ligjit për Sigurimin e Depozitave në bazë të përvojës operacionale, modernizimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjike të FSDK për të siguruar veprimtari efektive dhe produktive.




1.54% 1.47% 1.20% 0.61%

Kamatat në depozita, më të favorshmet në rajon

Bankat komerciale në Kosovë paguajnë normat më të larta të depozitave në rajon, prandaj paratë e qytetarëve në banka po shënojnë rritje të qëndrueshme nga viti në vit. Njëkohësisht nga 3.13 miliardë euro sa janë depozitat e përgjithshme në vend, rreth 120 milionë euro janë depozita të jorezidentëve në bankat komerciale të

Kosovës, kryesisht para të diasporës që i kanë depozituar nga bankat komerciale të vendit. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), norma mesatare e interesit në depozita në fund të korrikut të këtij viti në Kosovë ka qenë 1.54%, që paraqet nivelin më të lartë përgjatë vitit 2018 dhe ka shënuar rritje krahasuar

me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kur norma e interesit në depozita ishte 1.17%. Në anën tjetër, norma e interesit në depozita në Shqipëri është 1.20%, në Maqedoni 1.47%, ndërsa në Mal të Zi vetëm 0.61%.




Dekada e dyfishimit të depozitave

Depozitat në bankat komerciale të Kosovës janë rritur me ritëm shumë të shpejtë gjatë dhjetë viteve të fundit. Paratë e qytetarëve në bankat vendore janë dyfishuar nga viti 2008 e këndej, duke dëshmuar kështu stabilitetin e sektorit bankar dhe njëkohësisht besimin e palëkundur të qytetarëve te ky i fundit. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shuma e përgjithshme e depozitave në vitin 2008 ka qenë 1.44 miliardë euro, përderisa për vetëm një vit (2009) janë rritur për 300 milionë euro,

duke arritur në 1.74 miliardë euro. Në vitin 2010 depozitat kanë arritur në rreth 2 miliardë euro, derisa në vitin 2011 shuma e përgjithshme e mjeteve financiare të qytetarëve në banka ka kaluar shumë prej 2.1 miliardë euro. Në vitin 2012 depozitat kanë arritur në rreth 2.28 miliardë euro, ndërsa në vitin 2013 kanë arritur në rreth 2.45 miliardë euro. Në vitin 2014 depozitat kanë arritur në 2.537 miliardë euro, mbi 2.7

miliardë euro në vitin 2015, 2.9 miliardë euro në vitin 2016 dhe rreth 3.1 miliardë euro në vitin 2017. Ndërkaq, deri në korrik të këtij viti shuma e përgjithshme e depozitave ka arritur në 3.13 miliardë euro.





Bizneset rrisin depozitat

Depozitat e afatizuara të bizneseve në bankat komerciale janë rritur për 30.8% gjatë vitit 2017, në krahasim me vitin paraprak

Depozitat e afatizuara të bizneseve në bankat komerciale të Kosovës gjatë vitit 2017 kanë shënuar një rritje prej 30.8%, krahasuar me një vit më parë.

Bazuar në të dhënat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), të cilat janë prezantuar në raportin e stabilitetit financiar të muajit shtator të këtij viti, thuhet se stoku i depozitave të ndërmarrjeve arriti në 581.5 milionë euro, me pjesëmarrje 18.8 për qind në gjithsej depozitat në sistemin bankar të Kosovës.

Në raportin e BQK-së gjithashtu potencohet se rritja e depozitave të ndërmarrjeve u ndikua kryesisht nga rritja e depozitave të transferueshme prej 7.8 për qind, për shkak të efektit të bazës, deri sa në anën tjetër depozitat e afatizuara u karakterizuan me rritje më të lartë, 30.8 për qind, që mund të jetë ndikuar nga rritja e normës së interesit për këto depozita, e cila arriti në 1.73 për qind.

“Depozitat e ndërmarrjeve ishin për 13.8 për qind më të larta, krahas vitit të kaluar. Rritje më

13.8%

janë rritur depozitat e bizneseve në Kosovë gjatë vitit 2017, krahasuar me vitin paraprak.

24.6%

e depozitave të përgjithshme në vend janë mjete financiare të bizneseve

të theksuar shënuan depozitat e transferueshme, mirëpo për dallim nga ekonomitë familjare, rritje shënuan edhe depozitat e kursimit të ndërmarrjeve. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrjet është 1.7 për qind, kundrejt atyre për ekonomitë familjare që kishin një normë prej 1 për qind”, thuhet në raportin e stabilitetit Financiar të Bankës Qendrore të Kosovës.

Më tutje në raportin e BQK-së, thuhet se Mali i Zi dhe Kosova shënuan rritjen më të lartë të depozitave, me normë dyshifrore të rritjes. Sipas BQK-së, vendet e rajonit raportuan edhe për rritje të depozitave, por me shkallë mesatare lehtësisht më të ulët se vitin paraprak si rezultat i ngadalësimit të shkallës së rritjes në Shqipëri dhe Serbi. Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina shpejtuan rritjen në normë dyshifrore të rritjes, përderisa mesatarja vjetore e rritjes së depozitave për rajonin në tërësi ishte 6.8 për qind në 2017, nga 7.8 për qind sa ishte një vit më parë.